

DHURATA MË E BUKUR



QË IA KEMI BËRË VETES

DEMOKRACIA NË JETËN TONË

BESA (13), ERLIND (12), MELOS (12), ENGJULL (12), FLAKON (12), LORESA (12), YLLNESHA (12),


LEUTRIM (12), GRANIT (12), DAFINA (12)

Demokracia është si Dielli. Ajo ndriçon rrugën drejt suksesit dhe lumturisë

Ishte viti 507 p.e.s. Në atë kohë, në Athinë ndodhi diçka që do të ndryshonte të ardhmen e njerëzimit, njëherë e mirë. Lindi më e dashura demokraci, pikërisht në kryeqytetin e Greqisë. Me lindjen e demokracisë populli mori kurorën e vendimmarrjes.

Kjo kurorë, asnjëherë nuk e humbi vlerën e saj. Vetëm sa është përcjellur që nga atëherë e deri në ditët e sotme. Prandaj, ne si qytetarë të shtetit tonë demokratik e mbajmë këtë kurorë. Jemi ne ata të cilët vendosim për vetveten. Jemi të lirë ta bëjmë këtë gjë dhe jemi të lirë të zgjedhim përfaqësuesit tanë. Kjo pra është arsyeja pse themi se në demokraci udhëheq populli. Përpos të drejtës për të votuar, ne kemi edhe të drejta të tjera. Disa nga to janë: e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e arsimit, e drejta e familjes, e drejta e strehimit, etj. Prandaj, ne në shkollat e Kosovës kemi nxënës të feve të ndryshme, të etnive të ndryshme, të gjinive të ndryshme, etj. Kjo tregon se kemi frymë demokratike. Marrim shembull Anën. Ana është një mike imja e cila ka prejardhje rumune. Mirëpo, kjo nuk na pengon që ne të jemi mike, sepse në demokraci nuk ka kësolloj dallime.

Dy llojet e demokracisë janë: demokracia përfaqësuese (populli zgjedh përfaqësuesit) dhe ajo e drejtpërdrejtë (populli merr vendimet direkt). Ne sot kuptuam rëndësinë që ka demokracia. Kuptojeni edhe ju në mënyrë që së bashku të punojmë në forcimin e saj.



Dielli i jetës sonë, demokracia. E duam dhe së bashku e ndërtojmë atë



Ta duam njëri-tjetrin pa paragjykime. Vetëm kështu jemi demokratikë



Gazetarët e formës më të mirë të qeverisjes që quhet demokraci



Shkolla, institucioni më i dashur dhe i mbushur plot me dituri

BRENDA KUVENDIT

AURELA (12), DORENTINA (12), ERZA (11), ELIRA (12), DRINOR (12), ERGJAN (12), YLLJON (12),
ERION (13), LEGJEND (12), SARANDA (12), RINESA (12)



Ne sot nuk patëm rastin të ishim brenda në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Por, gjatë bisedës sonë, mësuam aq shumë për Kuvendin sa që menduam se me të vërtetë kemi qenë brenda këtij institucioni

Artikullin do ta fillojmë duke përshkruar disa nga parimet kryesore të deputetëve. Ato janë: përgjegjësia, ndershmëria, vetëmohimi, objektiviteti, aftësia udhëheqëse dhe integriteti moral. Por, çfarë do të thojnë këto fjalë? Përgjegjësia është ndjenja e detyrës dhe e obligimeve. Ndershmëria do të thotë të jesh i ndershëm dhe i saktë me popullin tënd. Vetëmohimi shfaqet atëherë kur një deputet mendon dhe kujdeset fillimisht për të tjerët, e pastaj për veten. Kurse, të jesh objektiv do të thotë të shohësh gjithmonë anën e të së vërtetës. Deputetë, gjithashtu, duhet të kenë aftësi për udhëheqje, pasi që të gjithë sytë e qytetarëve janë drejt tyre. Në fund është integriteti moral, i cili është shumë i rëndësishëm për një udhëheqës. Kjo sepse ata duhet ta bëjnë dallimin në mes të mirës dhe

të keqes dhe gjithmonë duhet ta zgjedhin atë që është më e mira për popullin.

Kuvendi, institucioni ku punojnë deputetët, ka për detyrë të krijoj ligje të ndryshme. Ne duam të ndërlihim edhe veten tonë me punën e Kuvendit. Po të mos ishin ligjet, jeta jonë do të ishte monotone dhe e çrregullt, sepse ligjet përcaktojnë dhe rregullojnë jetën e qytetarëve. Ligji i mbrojtjes së ambientit, ligji i shkollimit, ligji i punës, ligji i komunikacionit, janë këto vetëm disa nga ligjet e vendit tonë.


Shoqja jonë Aurela, sot shprehu dëshirën të ishte një deputete e Kuvendit të Kosovës dhe imagjinoi se çfarë do të bënte po të kishte këtë rol. Ajo tha se do t'i zgjidhte problemet e qytetarëve me qetësi, do t'i përfundonte detyrat e deputetes me shumë përgjegjësi dhe do t'i sillte shumë të mira qytetarëve të saj përmes ligjeve të cilat do t'i miratonte. Aurela na tha se dëshira e saj më e madhe do të ishte t'i bënte të gjithë qytetarët krenarë me vendimet e saj. Ky ishte artikulli ynë. Nga ne mirëupafshim!





Ja si duket Kuvendi i Kosovës nga brenda



Me shokët dhe shoqet e grupit



Për të pasur një të ardhme të ndritur ne duhet të mësojmë shumë. Vetëm kështu e ndihmojmë shtetin tonë dhe vetën tonë



Kur zilja e përgjegjësive bie, ne të gjithë duhet të bashkohemi t'i kryejmë përgjegjësitë tona për një botë më të mirë



Në të kaluarën gratë nuk kanë pasur edhe aq të drejta. Mirëpo, sot ato edhe udhëheqin shtetin e tyre

LIRIA PËR TË ZGJEDHUR

ERBLINA (12), ERDON (12), EDUARD (12), ALBION (12), BLEART (12), LEKTOR (11), LEONITË (12),
ELVINA (11), ENSAR (12)

Zgjedhjet dhe rëndësia e tyre ishin sot temë diskutimi brenda grupit tonë të vogël. Ne do të mundohemi që t'i bartim tek ju lexues të dashur informatat më të rëndësishme për këtë temë

Tung të dashur lexues, unë jam Lektori, dhe sot isha anëtar i grupit „Liria“. Përafërsisht 4 orë kemi diskutuar rreth shumë gjërave, por më e rëndësishmja ishte diskutimi rreth zgjedhjeve. Kishte mendime të ndryshme sa i përket kësaj teme dhe si mund t'i ndërlikim zgjedhjet me jetën tonë të përditshme. Kur edukatorja na pyeti se si grupi ynë i sheh apo i percepton zgjedhjet, i pari që foli, isha unë.


Për mua, zgjedhjet janë elementi pa të cilin asnjë shtet demokratik nuk mund të funksionojë. Duke u nisur nga ajo që vendi ynë ka demokraci përfaqësuese, për të cilën besoj që keni mësuar në artikullin e shkruar nga nxënësit e tjerë, ne qytetarët e Kosovës e kemi përgjegjësi të marrim pjesë në zgjedhje.

Përmes votës së lirë, qytetarët mbi moshën 18 vjeçare zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin vendime në të mirën e gjithë popullit. Nëna ime më tregoi që një herë nuk është treguar qytetare e përgjegjshme, duke mos marrë pjesë në procesin zgjedhor. Ajo ndihet shumë keq që në jetën e saj ka vepruar në këtë mënyrë.

Andaj mu drejtua mua duke më thënë „Ti ke shumë të drejta që duhet ti gëzosh. Që të jetësohen ato, kanë nevojë për një qytetar të angazhuar dhe shumë punëtor e përgjegjës për punën që bën.“ Le të bëjmë më të mirën për vendin tonë që të jemi aktiv. Aktiv mund të jemi edhe duke votuar. Ne do të votojmë kur të arrijmë moshën adekuate.




Zgjedhjet e para qendrore apo parlamentare që Kosova i organizoi si shtet i lirë ishin mbajtur në vitin 2001



Zgjedhjet nga përditshmëria e nxënësve. Në njërin anë është libri, ndërsa në anën tjetër gitara



Anëtarët e grupit „Liria“. Shumë të gëzuar që sot ishim gazetarë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Skender EmërLahu“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Ramjan, Viti